

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje prej gjyqtarëve, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Nebojša Boričić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

D. P. Beograd, R. e Serbisë

Kundër;

Y N, nga Peja

Palë përgjegjëse në ankesë,

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA...), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 21 Maj 2019, merr;

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga D. P., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014.**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, i datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP, me numër KPA...**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

1. Me datë 09 Tetor 2006, D. P., (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), në cilësinë e bartësit të drejtës pronësore, me të cilën kërkon ri-posedimin e ngastrës kadastrale, nr. ..., me sipërfaqe prej 1.01.77 ha, me kulturë tokë bujqësore(livadh), e cila gjendet në rr. "...", Komuna Kadastrale Pejë. Pala ankuese ka theksuar se është pronar ligjor me 1/1, pjesë ideale e pronës së kërkuar të cilën e ka trashëguar nga nëna e tij në bazë të vendimit gjyqësor. Po ashtu thekson se humbja e posedimit ka ndodhur si pasojë e rrethanave të viteve 1998/99 në Kosovë, ndërsa aktualisht prona e kërkuar është e uzurpuar, andaj kërkon ri posedimin e saj.

2. Së bashku me kërkesën në AKP pala ankuese ka dorëzuar *inter alia*:
 - Vendimin e Trashëgimisë, O br..., të dt. 30.09.1959, lëshuar nga Gjykata Komunale në Pejë, sipas të cilit e ëma e palës ankuese I. P., e ka trashëguar pronën e kërkuar pas vdekjes së babait të palës ankuese V. P. .
 - Kopjen e planit nr. ..., të dt. 22.11.1988, lëshuar nga departamenti i kadastrit në Pejë, e cila e paraqet palën ankuese pronar të vetëm të pronës së kërkuar(Sipas shënimit se, është i regjistruar si pronar në bazë të Vendimit mbi trashëgimin O nr. ..., të dt. 18.10.1984, të Gjykatës Komunale në Kaçanik).
 - Aktgjykimin P.nr. 968/87, të dt. 20.10.1988, të Gjykatës së Qarkut në Pejë, me të cilin babai i palës përgjegjëse U. N. dhe xhaxhai i tij R. N., obligoheshin që t'ia kthenin në posedim pronën e kërkuar palës ankuese.
 - Aktgjykimin nr. 233/92, të dt. 26.08.1992, të Gjykatës Supreme të Serbisë, me të cilin refuzohet ankesa e të paditurve Ujkan dhe R. N., ndërsa konfirmohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë nr. ..., i dt. 20.10.1988.
 - Vendimin nr. ..., të dt. 05.05.1996, të Gjykatës Komunale në Pejë ,me të cilin i kthehet në posedim palës ankuese prona e kërkuar në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Serbisë.
 - Fletën Poseduese nr. 2775, të dt. 22.02.2002, lëshuar nga kadastru i zhvendosur në Serbi, e cila e paraqet palës ankuese, si pronar me 1/1, pjesë ideale të pronës së kërkuar.
 - Më vonë në AKP, ka ofruar Letrat informuese, të dt. 01.01.2008, dhe 07.12.2011, me të cilat konfirmon se asnjëherë nuk e ka shitur pronën e kërkuar dhe as palëve përgjegjëse, se këtë pronë e ka rimarrë nga palët përgjegjëse dhe e ka shfrytëzuar gjer në vitin 1999, etj.
3. Njoftimi i kërkesës së palës ankuese nga ekipi i AKP-së, ishte bërë më 10 Tetor 2007, prona e kërkuar ishte gjetur se është livadh e pa uzurpuar nga askush. Me datë 27 Prill 2010, konfirmimi dhe notifikimi i pronës ishte bërë për mes Ortofotove dhe GPS koordinatave.
4. Me datë 18.08.2008, në AKP, është paraqitur Y. U. N., i cili ka kërkuar të drejtë ligjore në pronën e kërkuar, i njëjti e ka nënshkruar formularin e pjesëmarrjes në procedurë, dhe ka deklaruar se, prona e kërkuar është blerë nga babai i tij Ujkani dhe xhaxhai i tij Rexhepi nga e ëma e palës ankuese në vitin 1967, ndërsa pala ankuese ka për qëllim ta shes për së dyti herë. Se këtë pronë prej atëherë pa ndërprerje e kanë në posedim por nga qeveria e atëhershme nuk ishin lejuar me bartë në emër të tyre, ndërsa edhe tani janë në posedim të kësaj prone.
5. Në mbështetje të përgjegjës së tij ai ka paraqitur në AKP mes tjerash dokumentet vijuese;
 - Kopjen e Kontratës së Shitblerjes të dt. 01.06.1970, të pavërtetuar, e lidhur me prezencën e dy dëshmitarëve, në mes të shitëses, nënës së palës ankuese dhe blerësve, xhaxhait dhe babait të palës përgjegjëse, të cilët pronën kontestuese e blejnë për shumën prej 3.000.000(tre milion dinar).Në këtë kantatë ceket po ashtu se shitësja është bërë pronare e kësaj prone në bazë të vendimit mbi trashëgimin të vitit 1959.

- Dëftesë pagesa të dt. 05.09.1967, me të cilën nëna e palës ankuese me nënshkrimin e saj e konfirmon se i ka pranuar 20.000 dinarë të rinjë, nga pala e tretë,(familjar të palës përgjegjëse) për pronën e shitur ,në të njëjtën faqe, nënshkruhet dëftesa tjetër e dt. 03.09.1968, se i ka pranuar 30.000 dinar të rinjë, në emër të arës së shitur në Fushë Pejë ,por që nuk është specifikuar numri apo identifikimi i ndonjë ngastre kadastrale, (nënshkrimi i pranuesit të parave ngjan të jetë i palës ankuese).
 - Librezën Tatimore në emër të nënës së palës ankuese, nga e cila provohet se babai i palës përgjegjëse ka paguar tatimin për pronën për vitet 1984,1985 dhe 1986, në emër të saj.
 - Fletëpagesa tatimi për vitet 1971-1978, të cilat tregojnë se i babi i palës përgjegjëse, dhe S. N., kanë paguar tatimin për pronën lëndore.
 - Padinë e ushtruar në vitin 2001, nga babai i palës përgjegjëse në Gjykatën komunale në Pejë me të cilën kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore në pronën e kërkuar në bazë të blerjes së sajë në vitin 1967, prej nënës së palës ankuese.
 - Vendimin e Gjykatës të vitit 2001, me të cilin pezullohet procedura e shqyrtimit sipas padisë me që pala ankuese nuk jeton në Kosovë.
 - Letrën informuese të avokat U. H., i cili e anulon autorizimin e përfaqësimit të palës ankuese si i paditur në procedurë gjyqësore sipas padisë së babit të palës përgjegjëse.
 - Procesverbalin e gjykatës, të dt. 09.02.2007, e lëndës C.nr. 124/02, lidhur me shtyrjen e seancës gjyqësore në mungesë të palës së paditur (palës ankuese).
 - Letër informuese të dt. 22.02.2012, me të cilën pala përgjegjëse ka deklaruar se ai është njëri prej trashëgimtarëve të babait të tij.
6. Sipas raportit të verifikimit të datës 29 shtator 2014, dokumentet e paraqitura nga palët ishin gjetur dhe verifikuar pozitivisht për veç fletës poseduese nr. ... dt. 22.02.2002, të lëshuar nga kadastru i zhvendosur në Serbi, e cila e paraqet palën ankuese, pronar me 1/1, pjesë ideale të pronës së kërkuar, e cila ishte verifikuar negativisht.
7. Pala ankuese pasi është informuar nga AKP, lidhur me pretendimet e palës përgjegjëse, i njëjti kishte konfirmuar se ka pasur proces gjyqësor sipas padisë së tij kundër familjarëve të palës përgjegjëse për pronën kontestuese prej vitit 1988 dhe ishte përfunduar në vitin 1992, me vendim të Gjykatës Supreme të Serbisë ku i ishte konfirmuar e drejta pronësore, ndërsa në vitin 1996 i është kthyer posedimi me vendim gjyqësor nga familjarët e palës përgjegjëse. Po ashtu kishte deklaruar se mungesa e tij në Kosovë me që jeton në Serbi prej vitit 1959, ishte keqpërdor nga pala tjetër, ashtu që në vitin 2001 ishte ushtruar padi ndaj tij dhe në mënyrë jo ligjore prona ishte bartur në emër të palës përgjegjëse, të cilën nuk ua kanë shitur as ai, as nëna e ndjerë e tij. I Njëjti e paraqet Fletën poseduese të vitit 2011, nga e cila shihet se në kadastrë kjo pronë është e regjistruar në emër të palës përgjegjëse dhe disa personave të tjerë me mbiemër të njëjtë N.,(ky fakt ishte konfirmuar edhe *ex officio*, nga sekretaria e AKP-së në kadastrë Pejë). Po ashtu ofron dëshmi se ka paraqitur kërkesë në gjykatë për tu ndërprerë procedura e dytë gjyqësore për pronën e njëjtë.

8. Sekretaria e AKP-së nga provat e ofruara nga palët kishte konfirmuar se babai i palës përgjegjëse kishte paraqitur padi në vitin 2001, për konfirmimin e të drejtës pronësore në pronën e kërkuar dhe për këtë çështje ishte vendosur me aktgjykimin C.nr.124/02, dt.15.05.2009, në Gjykatën komunale në Pejë, me të cilin palës përgjegjëse i ishte konfirmuar e drejta pronësore e i cili Vendim, sipas ankesës së palës ankuese me Vendimin e Gjykatës së Apelit AC (GZ) nr.53/2013, të dt. 03.07.2014, ishte anuluar dhe çështja ishte kthyer në rigjykim.
9. Sekretaria *ex officio* kishte gjetur se lidhur me këtë çështje procedura gjyqësore ishte në vazhdim ende e pa përfunduar në gjykatën e shkallës së parë Pejë, ndërsa ishte nxjerrë vendim gjyqësor nga kjo gjykatë, me nr. P.nr.579/14, me dt.29.08.2014, me të cilin ishte vendosur masa e përkohshme ndaj paditësit U. N., për ndalimin e tjetërsimit apo çfarëdo mase apo ngarkese të pronës së kërkuar, deri në përfundim të procedurës gjyqësore.
10. Me 21 Tetor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), përmes vendimit të vet KPCC/D/A/260/2014 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i KKPK-së), e ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese. Në arsyetim të vendimit grupor, (paragrafi 39), që aplikohet në mënyrë specifike për kërkesën konkrete, KKPK-ja ndër të tjera ka theksuar se, nga provat e dorëzuara nga paraqitësi i kërkesës, nga palët përgjegjëse, ose palët e trata dhe të verifikuara edhe nga sekretaria ekzekutive tregohet se, para datës 16 tetor 2006, është parashtruar padi në gjykatën kompetente duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore për pronat e kërkuara. Në fund, KKPK ka theksuar se në përputhje me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme: Ligji nr. 03/L-079), përjashtohet juridiksioni i Komisionit sepse procedurat gjyqësore lidhur me kërkesën kanë filluar para datës 16 tetor 2006, datë kjo kur ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligji nr. 03/L-079.
11. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese D. P. me datë 24 Shkurt 2015 ndërsa palës përgjegjëse Y. N., me datë 06 Shkurt 2015. Me datë 10 Mars 2015, pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Me datë 24 Shkurt 2016, i ishte dorëzuar kopja e ankesës së palës ankuese palës përgjegjëse, megjithatë ai nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese;

12. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së është jo ligjor dhe jo i drejtë, i përfshirë me shkelje thelbësore të rregullave procedurale, aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe mos vërtetim të saktë apo jo të plotë të gjendjes faktike me rëndësi për vendosjen e kërkesës në mënyrë meritore.
13. Tutje në ankesë ndër të tjera thekson se, nuk pajtohet me konstatimin se KKPK-ja nuk ka juridiksion për çështjet të cilat janë iniciuar në gjykata të rregullta para datës 16 tetor 2006, ndërsa

bazuar në provat e paraqitura pretendon se është pronarë ligjor i pronës së kërkuar, se komisionit gjatë procedurës i ka ofruar prova të ndryshme për të dëshmuar të drejtën e tij, por nuk i është dhënë mundësia që në AKP, me palën tjetër ti ballafaqojnë argumentet në seancë shqyrtimi për këtë çështje komplekse pronësore për tu zgjidh çështja në themel, se pala përgjegjëse pa të drejtë këtë pronë ia ka uzurpuar, ndërsa me të kuptuar për proces gjyqësor të iniciuar nga pala përgjegjëse ka paraqitur ankesë në Gjykatë të Apelit e cila me vendimin e saj, vendimin e shkallës së parë e ka prish si jo ligjor dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim. Tutje i përsërit pretendimet e paraqitura edhe më parë në AKP se, prona është e tij të njëjtën nuk e ka shit as ai, as nëna e tij, si pretendohet nga pala tjetër gjoja në vitin 1967, dhe asnjëherë nuk është lidhë kontratë shitblerje, se kontestin për këtë pronë e ka zgjidhur në mënyrë gjyqësore, me aktgjykimin përfundimtar të viti 1992, të Gjykatës Supreme të Serbisë, dhe të drejtën e tij pronësore e mbrojnë KEDLNJ protokollat e saj, si dhe aktet e tjera ndërkombëtare, etj.

14. Në fund propozon që gjykata supreme të bie vendim me të cilin e anulon Vendimin e ankimuar dhe lëndën ia kthen në rivendosje KKPK-së, ose të aprovoj ankesën dhe të bie vendim me të cilin pranohet kërkesa e tij për kthimin e posedimit të tokës bujqësore lëndore.

Pranueshmëria e ankesës

15. Gjykata Supreme shqyrtoi Vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejme: LPK), ankesa është e pranueshme sepse ajo është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079, i cili parasheh që pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda afatit prej tridhjetë (30), ditë nga dita e pranimit të Vendimit.

Arsyetimi ligjor;

16. Gjykata Supreme e Kosovës pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, Vendimit të ankimuar si dhe shkresave të tjera të lëndës gjen se, vendimi i kundërshtuar i KKPK-së ishte marr pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi një bazë të tillë edhe e drejta materiale dhe ajo procedurale janë zbatuar në mënyrën e duhur. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.
17. Gjykata Supreme konstaton se vendimi i kundërshtuar i KKPK-së, mbështetet në nenin 18 të Rregullores së UNMIK nr.2006/50, e ndryshuar me Ligjit nr. 03/L-079, e cili nen përcakton se; *“Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për çdo kërkesë nga neni 3.1 i kësaj Rregulloreje që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, me kusht që procedura gjyqësore lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje”*. Rrjedhimisht, dispozita e nenit të cituar duhet të kuptohet se juridiksioni i AKP-së përjashtohet nëse pala apo palët kanë dorëzuar kërkesë në gjykatën kompetente për konfirmimin e të drejtës pronësore, para datës 16 tetor 2006 (data e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

18. Komisioni në vendimin e vet e ka bërë të qartë se nga provat e dorëzuara nga paraqitësi i kërkesës dhe pala përgjegjëse, dhe të verifikuara edhe nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, tregojnë se prindi i palës përgjegjëse në kërkesën e palës ankuese, ka paraqitur padi kundër palës ankuese, (palë kërkuese në AKP), në Gjykatën Komunale të Pejës, për vërtetimin e të drejtës pronësore në pronën kontestuese para datës 16 tetor 2006. Padia është ushtruar para se të jetë ushtruar kërkesa në AKP nga pala ankuese, andaj çështja që duhet dhënë përgjigje bazuar në kërkesën dhe tani ankesën e palës ankuese, është nëse KKPK ka pasur juridiksion apo jo për të vendosur në mënyrë meritore këtë çështje dhe nëse kërkesa e palës ankuese në AKP është paraqitur para datës 16 Tetor 2006.
19. Nuk është kontestuese se pala ankuese dhe pala përgjegjëse, kanë pretendime të më hershme pronësore për pronën e kërkuar. Sipas provave në shkresa të lëndës zanafilla e kësaj çështje daton prej viteve të pesëdhjeta, kur u është dhënë me qira shfrytëzimi i kësaj prone familjarëve të palës përgjegjëse, nga e ndjera nëna e palës ankuese, apo prej vitit 1967 kur pala përgjegjëse pretendon se babai dhe xhaxhai i tij e kanë blerë pronën kontestuese dhe prej atëherë e kanë në posedim dhe shfrytëzim. Në anën tjetër pala ankuese e mohon se ai, apo nëna e tij e ndjerë se këtë pronë ua kanë shitur ndonjëherë familjarëve të palës përgjegjëse. Po ashtu është fakt se në vitet e 80-ta dhe 90-ta, për vërtetimin e të drejtës pronësore janë udhëhequr dhe janë nxjerrë vendime gjyqësore me të cilat palës ankuese i është njohur e drejta e pronësisë në këtë pronë. Ndërsa prej vitit 2001, përsëri për këtë çështje pronësore udhëhiqet procedurë gjyqësore në gjykata të rregullta dhe gjer më tani nuk provohet se kjo çështje është përfunduar me një vendim përfundimtar. Nga theksimet në ankesë dhe shkresave të lëndës provohet se për këtë pronë është vënë masa e përkohshme e sigurisë ndaj paditësit- palës përgjegjëse, që mos ta tjetërsoj apo mos ta ngarkoj me çfarëdo barre pronën kontestuese gjer në vendosje meritore të formës së prerë.
20. Nisur nga faktet e cekura më lartë është evidente dhe mund të konkludohet pa dyshim se ky kontest pronësor në mes palëve nuk e ka burimin nga rrethanat e viteve 1998/99, por është shumë më i hershëm, dhe ende i pa përfunduar me epilog përfundimtar. Pra si çështje kontestuese për zgjidhjen e së cilës është ushtruar padi në gjykatë të rregullt para datës 16 Tetor 2006, këtë fakt nuk e mohojnë asnjëra nga palët. Andaj KKPK ka marrë vendim të drejtë me hedhjen poshtë të kërkesë në kuptim të nënti 18 të Ligjit nr.03/L-079, sepse kjo dispozitë shprehimisht përjashton juridiksionin e KKPK-së për të vendosur në mënyrë meritore, kur çështja është në procedim nga një gjykatë e rregullt para datës 16 tetor 2006, pa marrë parasysh nëse është proces i rregullt ligjor apo jo, sepse nuk është kompetencë e Gjykatës Supreme apo e KKPK-së, të vlerësoj ligjshmërinë e një procesi gjyqësor, para se të merret vendim gjyqësor meritore, që e ka bërë çështjen objekt i përsëritjes së procedurës sipas kërkesës së palës ankuese në Gjykatën e Apelit, dhe pas anulimit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.124/2002, dt.15.05.2009, me Vendimin e Gjykatës së Apelit GZ (CA). nr.53/2013, të dt. 03.07. 2014, dhe kthimin e çështjes për përsëritje të procedurës.

21. Prandaj, pala ankuese dhe pala përgjegjëse në ankesë duhet të vazhdojnë me kërkesat dhe pretendimet e tyre në bazë të argumenteve dhe dokumenteve që i posedojnë në gjykatën me kompetencë të rregullt përkatëse, për të përfunduar çështjen e cila është ende e pa përfunduar, lidhur me vërtetimin e të drejtës pronësore.
22. Nga të gjitha arsyet e përmendura më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3.(c) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafi 1(d) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
23. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese apo palëve të tjera të interesuara lidhur me të drejtën pronësore në pronën e kërkuar, dhe nuk është me ndikim ndaj rezultatit përfundimtar në gjykata të rregullta kompetente.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-020-2016, me datë 21 Maj 2019

**Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi**

**Kryetari i Kolegjit,
Beshir Islami**